



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:240798

Datë: 25.07.2024

Numri i dokumentit: 05979478

C-IV-14-2796

Ankuesit

O Th nga Podujeva

Përfaqësuar nga av. B I, Prishtinë

Kundër

E paditura

N.SH “FAN Zahir Pajaziti”, përfaqësuar nga **Agjencia Kosovare e Privatizimit**, lagja Lakërishte- rr. “Dritan Hoxha”, nr. 55, Prishtinë.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), gjyqtari Dr.sc.Murat Hulaj, me dt.22 korrik 2024, lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET pjesërisht** ankesa si e bazuar dhe **NDRYSHOHEN** Vendimi i Autoritetit të Likuidimit të AKP-së nr.PRN046-0245 i dt.26 mars 2014.
- II. OBLIGOHET** e paditura AKP, që ankuesit **O Th** në emër të kompensimit për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës t’i paguaj shumën prej **2,017.44€**, si dhe në emër të interesit ligjor prej 10% të shumës themelore ti paguaj shumën **201.74€**
- III.** Shumat e aprovuara si në pikën 2 të dispozitivit do të përmbushen në pajtim të prioritetit sipas kategorisë së përcaktuar të kërkesave dhe interesave në procedurën e likuidimit.
- IV. OBLIGOHET** e paditura AKP, që përfaqësuesit të ankuesit t’ia paguaj shpenzimet e përfaqësimit në shumë prej **124.00€**.

Rrethanat faktike dhe procedurale

Me dt.16 prill 2014, përfaqësuesi i ankuesit av. B I ka dorëzuar paraqitur ankesë kundër Vendimit të Autoritetit të Likuidimit (tutje AL) nr. PRN046-0245 i dt.26 mars 2014, me të cilin i është refuzuar kërkesa për kompensim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës në shumë të pa specifikuar, nga NSH “FAN Zahir Pajaziti” (në likuidim). I autorizuari ankuesit ka bërë dorëzimin e ankesës, në të thekson se të gjithë punëtorët ishin pre e ndërprerjes së marrëdhënies së punës nga ndërmarrja dhe rrjedhimisht të gjithë kanë të drejtë në kompensim për ndërprerje të parakohshme të marrëdhënies së punës. AKP nuk ua kishte mohuar këtë, por AKP-ja, ua ka refuzuar kërkesat e tyre, duke pretenduar se këto kërkesa për kompensim për ndërprerje të parakohshme të marrëdhënies së punës janë të parashkruara. Përfaqësuesi konsideron se kërkesa e punëtorit nuk është parashkruara dhe se punëtorët e kësaj ndërmarrje kanë të drejtë në kompensim duke ju referuar ligjeve që janë në fuqi në Kosovë. I ka bashkangjitur: Kopjen e vendimit të kundërshtuar, Kopjen e njoftimit për ndërprerje të marrëdhënies së punës, Kopjen e 20%-shit.

Me anë të parashtresës së dt.03 qershor 2020, i autorizuari i ankuesit ka bërë precizimin e kërkesës, duke i kërkuar ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës në emër të 6 pagave në shumë prej 3,026.16€, me kamat prej 10%, si dhe i ka kërkuar shpenzimet e procedurës. Së bashku me të ka bërë dorëzimin e kopjes së njoftimit për ndërprerje të marrëdhënies së punës, Listën e punëtorëve të cilët kanë pranuar njoftimin për ndërprerje të marrëdhënies së punës, , Lista e pagave të llogaritura për tre muaj dt.31.03.2006, Listën e punëtorëve që kanë përfituar nga 20%,

Me dt.19 prill 2024, e paditura AKP-ja, parashtrori mbrojtje në të cilën pohoi se AL ka kryer një vlerësim të saktë të rrethanave faktike dhe zbatim të drejtë të dispozitave ligjore. E paditura pohoi se ankesa është e pa pranueshme pasi që konsideron se është e rëndësishme të theksohet se objekti i kësaj procedure gjyqësore është vetëm ligjshmëria. Në këtë kontekst 74.2 i Ligjit 06/L-086 parashikon që ankesat e dorëzuara në DHPGJS kundër vendimeve të AL-së duhet të bazohen në pretendimet se procesi i likuidimit nuk është kryer në përputhje me Ligjin 04/L-034 për AKP-në. Parashtruesi nuk ka treguar se cilin nen e ka shkelur të Ligjit 04/L-034 është shkelur nga AL-ja me marrjen e vendimit. Në varësi të dispozitave të mësipërme kërkesa duhet të jetë parashtruar në gjykatë apo autoritet tjetër kompetent brenda 3 vjetësh nga koha kur parashtruesi ka fituar të drejtën të kërkoj kompensim. Në fund e paditura AKP propozon gjykatën që ankesa të refuzohet si e pa pranueshme dhe pa bazuar.

Arsyetimi ligjor:

Ankesa aprovohet pjesërisht si e bazuar dhe ndryshohet vendimet e kundërshtuara të AL-së

Në bazë të nenit 2.4 dhe nenit 77.1.1.1 të Ligjit Nr.06-L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejshëm Ligji për Dhomën e Posaçme), gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji.

Në bazë të nenit 76.3 të Ligjit mbi Dhomën e Posaçme, në lidhje me nenin 398 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjykata vlerëson se faktet që përmban ankesa e vërtetojnë atë dhe merr këtë aktgjykim pa caktuar seancë dëgjimore.

Neni 42 pika 2 e Ligjit për Dhomën e Posaçme, parasheh se pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka barrën e dëshmisë për të dëshmuar vërtetësinë e pretendimit të tillë, duke paraqitur parashtrësat apo duke paraqitur provat materiale (të dokumentuara, fizike dhe/ose dëshmuese), ndërsa, pika 3 parasheh se pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka mundësinë e arsyeshme për të paraqitur apo dorëzuar provat materiale për të mbështetur një pretendim të tillë, nëse pala e tillë dështon që të paraqesë apo dorëzojë provat e tilla, atëherë vlerësohet se pala nuk ka ofruar barrën e dëshmisë lidhur me pretendimin e tillë.

Sipas nenit 7 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, palët kanë për detyrë ti paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla. Me fjalë të tjera, kushdo që thotë diçka duhet ta dëshmojë atë (ei incumbit probatio qui dicit).

Neni 55.1 i Ligjit të Punës Nr. 03/L-212 (si ligj në fuqi në kohën e nxjerrjes së vendimit) parasheh që: “I punësuari ka të drejtë në pagë, e cila përcaktohet me Kontratën e Punës, në pajtim me këtë ligj, Kontratën Kolektive, Aktin e Brendshëm të Punëdhënësit” .

Gjykata vlerëson se nuk është kontestuese në mes palëve fakti se ankuesi ishte një punëtor i NSH “Fan Zahir Pajaziti” në Podujevë. Në këtë çështje, kontestuese, ndërmjet palëve është çështja e parashkrimit të kërkesës së ankuesit për kompensim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës. E paditura e kundërshton kërkesën e ankuesit duke pretenduar se e njëjta është parashkruar, me arsyetim se ankuesi nuk ka ndërmarrë ndonjë veprim me qëllim të ndërprerjes së këtij afati. Ankuesi, bazën e kërkesës së tij e mbështet në Listën e rrogave të dt.31.03.2006, Kopjen e njoftimit të ndërprerjes së marrëdhënies së punës te datës 24 mars 2006, Kopjen e librezës së punës, Listën e 20%-it si dhe në pohimet e tij të parashtruara në ankesë.

Nga Lista e rrogave të mbetura borxh të dt.31.03.2006, vërtetohet fakti se ankuesi kishte paga në shumë prej 504.36€.

Andaj, gjykata i pranon si prova relevante dhe të bazuara listë e pagave të dt.31.03.2006, si dhe librezën e njoftimit për ndërprerje të marrëdhënies së punës për të arritur në përfundim se ankuesi ka ofruar shërbime punë për NSH-në dhe se NSH i ka mbetur borxh pagat. E paditura nuk ka dëshmuar të kundërtën dhe nuk ka dorëzuar ndonjë provë për të vërtetuar faktin se ankuesi nuk kishte ofruar shërbime pune për NSH në periudhën e lartcekur, apo se nuk i takon dëmshpërblimi për ndërprerje të marrëdhënies së punës.

Me rastin e aprovimit të shumës lidhur me kërkesën për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës, gjykata u bazua në nenin 12.2 i Rregullores së UNMIK- ut 2001/ 27 (si ligj në fuqi në kohën e ndërprerjes së marrëdhënies së punës) thotë që: “Në rastet e largimit të shkallës së gjerë nga puna zbatohen dispozitat e mëposhtme: (dh) punonjësi nuk mund të largohet nga puna derisa

punëdhënësi të mos ia ketë paguar atij një dëmshpërblim të njëkohshëm. Dëmshpërblimi duhet t'i paguhet punonjësit në datën e shkëputjes së kontratës së punës sipas shkallës së mëposhtme:

- (i) prej 2 deri në 4 vjet stazh 1 pagë mujore;
- (ii) prej 5 deri në 9 vjet stazh 2 paga mujore;
- (iii) prej 10 deri në 19 vjet stazh 3 paga mujore;
- (iv) prej 20 deri në 29 vjet stazh 4 paga mujore;
- (v) 30 vjet stazh e më tepër 5 paga mujore;

Gjykata e aprovoi shumën si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke u bazuar në pagën e fundit të pa paguar, në listën e tri pagave ku ankuesi pagën e kishte në shumë prej 504.36€, kurse nga Libreza e punës si dhe njoftimi për ndërprerje të marrëdhënies së punës vërtetohet se ankuesi kishte ofruar shërbime për NSH-në në periudhë prej 21 viteve. Andaj, gjykata në bazë të dispozitave ligjore erdhi në përfundim se ankuesit i takojnë 4 paga e që i bie ($4 \times 504.36€ = 2,017.44€$).

Gjykata ka vlerësuar edhe pretendimet e tjera dhe kundërshtimet e palës së paditur në lidhje me objektin e kontestit, por të njëjtat nuk kanë ndikuar për të vendosur ndryshe në këtë çështje. Pretendimi i të paditurës se kërkesa e ankuesit e tëra është parashkruar, nuk është plotësisht i saktë. Po ashtu, gjykata vlerëson se parashkrimi është ndërprerë me njoftimin e datës 24 mars 2006 dhe kësaj pretendimi i të paditurës, se kërkesa është parashkruar për tërë detyrimin nuk është i drejtë dhe nuk gjen mbështetje në dispozitat ligjore.

Gjykata vëren se letra e datës 26 mars 2006, është një njoftim i përgjithshëm për kreditorët potencial dhe kësaj nuk përcakton statusin individual të secilit ankues në kuptim të ekzistimit të marrëdhënies së punës dhe si e tillë nuk mund të shërbejë si e vetmja bazë për tu njohur të drejtën për paga të papaguara, por e njëjta duhet të shihet edhe në lidhshmëri me dëshmitë tjera, të dorëzuara nga ankuesi, siç është arsyetuar më lartë. Ankuesi me letrën e datës 26 mars 2006 ishte njoftuar se punësimi i tij përfundon me rastin e privatizimit të NSH dhe se çdo kërkesë eventuale që mund të ketë ndaj NSH, duhet ta parashtrijë me rastin e inicimit të procedurës së likuidimit ndaj NSH. Futja e NSH-së në procedurë të likuidimit në bazë të dispozitave ligjore ka qenë detyrë e të paditurës dhe nuk është varur nga vullneti i ankuesit, kësaj ankuesi ka pasur pritje legjitime lidhur me fillimin e procedurës së likuidimit dhe parashtrimin të pretendimeve të tij kreditorë në po atë procedurë. Vonesa e fillimit të procedurës së likuidimit të NSH nuk mund ti atribuohet ankuesit dhe kësaj ti mohohet e drejta në kompensim vetëm mbi faktin e afatit të parashkrimit, përderisa ka qenë obligim ligjor i të paditurës për fillimin e kësaj procedure dhe përderisa ankuesi me letrën e lartcekur është njoftuar se kërkesat kreditorë që mund ti ketë duhet ti parashtrijë kur të fillojë procedura e likuidimit. Njëherit një interpretim i tillë është në pajtim edhe me precedentët e DHPGJS-së dhe të Kolegjit të Ankesave (AC-I-20-0282, AC-I-20-0033, AC-I-20-0168, AC-I-20-0183 etj).

Nisur nga kjo gjendje, gjykata vie në përfundim se ankuesi O Th, kishte ofruar shërbime punë për NSH dhe se NSH i kishte mbetur borxh pagat dhe kësaj i takon e drejta në kompensim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës, në shumën e aprovuar.

Gjykata e aprovon shumën në lartësi prej 201.74€ në emër të interesit ligjor bazuar në nenin 37.3 të shtojcës së Ligjit nr. 04 / L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit. Sipas nenit të lartcekur të gjitha kërkesat e bëra ndaj Ndërmarrjes mund të përfshijnë kamatë në çfarëdo shume themelore të grumbulluar deri para datës së Vendimit të Likuidimit, me kusht që kjo kamatë të mos tejkalojë 10% (dhjetë për qind) të shumës themelore.

Andaj në bazë të të lartcekurave dhe në pajtim me nenet 54.1 dhe 74.4 të Ligjit për Dhomën e Posaçme u vendos si në dispozitiv të aktgjykimit.

Shpenzimet gjyqësore

Gjykata Vendimin mbi obligimin që e paditura AKP, ta kompensoj përfaqësuesin e ankusit për t'ia paguar shpenzimet e përfaqësimit në bazë të Tarifës së Odës së Avokatëve të Kosovës në shumën prej **124.00€** sipas specifikimit vijus: Për hartimin e padisë në shumë prej 104.€, si për taksa gjyqësore në vlerë prej 20.€ për padi. Këto shpenzime u morën në përputhje me neni **62, paragrafi 1 dhe 2, te Ligjit për Dhomën e Posaçme**, është përcaktuar se *“Aktgjykimi i formës së prerë lidhur me një kërkesë apo ankesë duhet të përfshijë një vendim për shpenzimet e lëndës në mes të palëve. Pala e pasuksesshme urdhërohet t'i paguajë shpenzimet ashtu siç përcaktohen me aktgjykimin e formës së prerë”*. Në këtë çështje kontestimore, pala paditëse ka kërkuar kompensimin e shpenzimeve gjyqësore, ndërsa pala e paditur nuk i ka kërkuar ato. Gjykata, konform dispozitave të lartpërmendura, në pajtim me Udhëzimin Administrativ për Taksat Gjyqësore dhe Tarifën e Odës së Avokatëve të Kosovës, ia ka njohur paditësit të drejtën në kompensimin e shpenzimeve procedurale, pasi i njëjti e ka fituar gjykimin, në shumat si në vijim: 104.00 €, për përpilimin e padisë nga avokati dhe 20.00 €, për taksë gjyqësore për padi, në shumën e përgjithshme prej 124.00 €, duke e obliguar te paditurën AKP si me lartë.

Këshillë juridike

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrahet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Dr.sc.Murat Hulaj, Gjyqtar
